



ALBANIAN HELSINKI COMMITTEE



Suedi
Sverige

RAPORT MBI SITUATËN E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT NË SHQIPËRI PËR VITIN 2019



TIRANË, MARS 2020

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Përmirësimi i situatës të të drejtave të njeriut në Shqipëri nëpërmjet forcimit të shtetit të së drejtës – Klinika ligjore XIII”, zbatuar nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit dhe mbështetur financiarisht nga organizata Civil Rights Defenders, me fonde të Qeverisë së Mbretërisë Suedeze.



Gjetjet dhe konkluzionet e pasqyruara në këtë raport vjetor, janë kontribut i një sërë nismash të zbatuara nga Komiteti Shqiptar i Helsinkit gjatë vitit 2019, me mbështetjen financiare të Civil Rights Defenders, Fondacioni “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë”, Ambasada e SHBA-së në Shqipëri, Ambasada Hollandeze në Shqipëri, Ambasada Britanike, Ambasada Gjermane në Shqipëri, etj.

Përmbajtja e këtij raporti është përgjegjësi e plotë e Komitetit Shqiptar të Helsinkit dhe nuk reflekton qëndrimin e donatorëve që kanë mbështetur financiarisht veprimtarinë tonë, përfshi Qeverinë Suedeze ose organizatën Civil Rights Defenders që mbështeti realizimin e këtij raporti.

Përgatiti:

- 1. Znj. Ardita Kolmarku, Juriste/Koordinatore e Projektit Klinika Ligjore Falas, KShH**

Rishikuan:

- 1. Znj. Erida Skëndaj, Drejtore Ekzekutive, KShH**
- 2. Z. Niazi Jaho, Këshilltar Ligjor, KShH**

Përktheu: Guri Lekloti

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Autor: ©Komiteti Shqiptar i Helsinkit

Rr. Brigada e VIII-të, Pallati “Tekno Projekt”

Shk. 2 Ap. 10, Tirana-Albania

Kutia Postare nr.1752

Tel: 04 2233671

Mob: 0694075732

E-mail: office@ahc.org.al;

Web site: www.ahc.org.al

PËRMBAJTJA

Përmbledhje Ekzekutive	3
I. SITUATA E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT GJATË VITIT 2019	
1. Zbatimi i reformës në drejtësi	5
2. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar	8
3. E drejta për të zgjedhur e për t'u zgjedhur	8
4. Aksesimi në drejtësi i grupeve vulnerabël	9
5. Të drejtat e grupeve të marginalizuara në këndvështrimin e KShH-së	10
6. Ofrimi i shërbimeve ligjore falas ndaj qytetarëve, përfaqësimi në gjykatat vendase dhe në Gjykatën e Strasburgut	10
7. Respektimi i të drejtave të personave të ndodhur në kushtet e kufizimit të lirisë	12
8. Qasja e të rinjve ndaj tolerancës fetare	13
9. Liria e tubimeve paqësore	14
10. Liria e shprehjes	14
11. Konsultimi publik dhe gjithëpërfshirja në vendimmarrje	15
II. ANEKS 1	16
Të dhëna të kategorizuara për ankesat e trajtuara gjatë vitit 2019	

P Ë R M B L E D H J E E K Z E K U T I V E

i. Gjatë vitit 2019, KShH ka ndërmarrë misione monitorimi, fushata ndërgjegjësimi, ka reaguar publikisht në rastet e shkeljeve të të drejtave dhe lirive të njeriut, ka ushtruar presion pozitiv ndaj institucioneve shtetërore me qëllim marrjen e masave për ushtrimin efektiv dhe moscënimin e këtyre të drejtave. KShH ka vijuar të ofrojë shërbime ligjore falas për grupet në nevojë, si dhe ka përfaqësuar me sukses çështje me interes publik, sikurse kanë qenë ndotja e lumit Gjanicë në Gjykatën administrative të shkallës së parë Tiranë dhe dy raste të fituara në Gjykatën e Strasburgut.

ii. Procesi i vettingut përbën një nga shtyllat më të rëndësishme të reformës në sistemin e drejtësisë. Deri në fund të muajit dhjetor 2019, vetëm 27% e subjekteve i janë nënshtruar këtij procesi në shkallën e parë, ndërkohë që Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ka ezauruar gati gjysmën e mandatit të tij (2.5 vjet nga 5 në total). Bashkëpunimi i qytetarëve në procesin e vettingut vlerësohet si pro-aktiv, tregues i besimit të tyre në rezultatet e tij.

iii. Maturimi i institucioneve të vettingut, ankimet e Komisionerëve Publikë, rekomandimet e ONM-së, dhe orientimet e dhëna nga Kolegji i Posaçëm i Apelimit kanë kontribuar në konsolidimin e jurisprudencës së vettingut dhe adresimin e disa çështjeve të diskutueshme për standartet e ndryshme të vërejtura në të kaluarën. Kriteri i pasurisë është kriteri mbizotërues që sjellë shkarkimin e një numri të konsiderueshëm subjektsh. Pavarësisht përmirësimeve, zbatimi i parimit të proporcionalitetit për shkeljet e konstatuara në kriterin e pasurisë, nuk mund të thuhet se ka ndjekur plotësisht një linjë të unifikuar vendimmarrje nga organet e vettingut, në mënyrë të veçantë për subjektet që kanë rrethana faktike të ngjashme.

iv. Gjatë vitit 2019, nuk kanë qenë funksionale dy organe të rëndësishme të sistemit të drejtësisë: Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese, duke penguar aksesin e qytetarëve në këto institucione. Vakancat kanë krijuar grumbullim të stokut të konsiderueshëm të çështjeve penale, civile dhe administrative në Gjykatën e Lartë. Referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga KLP dhe KLGJ, edhe në gjykatat dhe prokuroritë më të ulëta ka patur vakanca, çka ka ndikuar në vonesat në gjykimin e çështjeve.

v. Ngritja me rreth 20 muaj me vonesë e Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe atij të Prokurorisë, vështirësitë apo vonesat që këto institucione patën në drejtim të pajisjes me infrastrukturë, personel dhe buxhet, solli edhe përballjen e tyre me volum të lartë pune. Veprimtaria e dy Këshillave gjatë vitit 2019, mundësoi ndër të tjerash, miratimin e një sërë aktesh normative që kushtëzonin vendimmarrjen efektive të tyre, zhbllokimin e ngërçit për emërimin dhe caktimin në detyrë të magistratëve të diplomuar në Shkollën e Magistraturës vitet e kaluara, miratimin e kuotave për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magistraturës të magistratëve të rinj, emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm, krijimin e prokurorisë dhe gjykatës së posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar (pavarësisht sfidave me të cilat ato vijnë në të përballen ende), etj. Në veprimtarinë e këtyre Këshillave nevojitet të adresohen më mirë gjatë vitit 2020, transparencja e materialeve të komisioneve të Këshillave në faqet zyrtare, publikimi i procesverbaleve të transkriptuara nga KLP dhe atyre audio nga KLGJ, përcaktimi i çështjeve prioritare që do të adresohen nga KLP për vitin 2020, ri-organizimi i gjykatave nga KLGJ, realizimi me ritme dinamike i procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të gjykatës së lartë nga KLGJ, veçanërisht i anëtarëve që vijnë nga radhët e gjyqësorit, etj.

vi. Vendimmarrja e KED evidenton një numër të ulët kandidaturash që plotësojnë kriteret dhe kushtet formalo – ligjore si për në Gjykatën Kushtetuese dhe për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, tregues i faktit se këto kritere janë të forta dhe se burimet njerëzore të interesuara për këto pozicione janë të pamjaftueshme për të garantuar një konkurrueshmërinë konform legjislacionit në fuqi.

vii. Në përputhje me legjislacionin në fuqi, kemi mendimin se KLP, KLGJ dhe KED duhet të hartojnë politika strategjike për plotësimin e vakancave në sistemin e drejtësisë, të cilat të përçojnë besim për meritokracinë dhe paanshmërinë e procesit tek profesionistët e së drejtës dhe të

inkurajojnë profesionistët e rinj që i plotësojnë kriteret, për të kandiduar dhe për të sjellë ndryshimet e kërkuara nga qytetarët sa i takon dhënies së drejtësisë me paanshmëri, profesionalizëm, transparencë dhe efikasitet.

viii. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar nevojitet të intensifikohet, ndërkohë që roli i SPAK-ut dhe Gjykatës së Posaçme është vendimtar në këtë drejtim. Këto institucione u ngritën me vonesë në fund të 2019-ës. Veprimtaria e tyre gjatë vitit 2020 kemi mendimin se duhet të përçojë tek publiku besimin se, fenomeni i korrupsionit dhe krimit të organizuar ndëshkohet me paanshmëri dhe pa selektivizëm, pavarësisht nga bindjet, përkatësitë apo pozita zyrtare e njerëzve të përfshirë në këto krime. Gjithashtu lind nevoja që Kuvendi të rishikojë kuadrin ligjor për nevojën e ekzistencës së njësive të brendshme të sinjalizimit të korrupsionit, pasi zbatimi i legjislacionit për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve shënon nivele tepër të ulëta.

ix. Zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të dt.30 Qershor 2019 u zhvilluan në një klimë të pazakontë për shkak të bojkotimit nga partitë opozitare si dhe në një situatë tejet të politizuar, e shoqëruar me forma të ndryshme presioni ndaj zgjedhësve, për të ushtruar ose jo të drejtën e tyre kushtetuese të votës. Marrëveshja politike e arritur mes palëve në kuadër të reformës zgjedhore është pozitive pasi mundëson përfshirjen e opozitës jashtë parlamentit. Nga ana tjetër, mënyra se si po realizohet diskutimi i propozimeve të palëve për ndryshime në Kodin Zgjedhor, po cenon transparencën, gjithëpërfshirjen dhe konsultimin publik, në zhvillimin e kësaj reforme të rëndësishme. Deri më tani, KShH vëren se palët nuk kanë reflektuar vullnet real për depolitizimin e plotë të organeve të administrimit zgjedhor, përfshi këtu KQZ-në.

x. Gjatë vitit 2019, KShH ka trajtuar 187 ankesa të përcjella nga qytetarët. Rreth 90% e këtyre ankesave i përkasin kategorisë së individëve të ndodhur në kushtet e kufizimit të lirisë. Rreth 10% e ankesave janë adresuar nga shtetas të tjerë lidhur me dhunën në familje, diskriminimin gjatë marrëdhënieve të punës si dhe ankesa ndaj sistemit të drejtësisë.

xi. Grupet në nevojë vijnë në përballen me forma të ndryshme të diskriminimit, ku ndër më të prekura janë përfaqësues të Minoritetit Rom dhe Egjiptian, personat me orientim të ndryshëm seksual apo për shkak të identitetit të tyre gjinor, gratë, si dhe personat që jetojnë në kushte tepër të vështira jetese dhe të varfërisë. Dhuna në familje vijon të jetë tepër shqetësuese, duke çuar në humbjen tragjike të jetës së disa femrave. Mekanizmat parandalues të dhunës në familje nuk kanë qenë efektiv.

xii. Në muajin Shtator 2019, Gjykata e Strasburgut, në çështjen e përfaqësuar me avokatë të KShH-së, Prizreni kundër Shqipërisë (Aplikim nr. 29309/16), konstatoi se vdekja e të dënuarit në kushtet e privimit të lirisë nën mbikqyrjen e autoriteteve nuk u hetua efektivisht nga prokuroria. KShH shpreh shqetësimin mbi rritjen e numrit të ankesave të shtetasve për ushtrim dhune brenda institucioneve të mbyllura (burgje/ komisariate), përkatësisht 10 raste në 2019, në krahasim me 3 ankesa të trajtuara gjatë vitit 2018. Personeli mjekësor që viziton këta shtetas nuk denoncon në prokurori, ndërkohë që nga monitorimi i kryer nga KShH, evidentohet një hetim jo i plotë dhe i gjithëanshëm i prokurorisë.

xiii. KShH i është bashkuar organizatave të medias, për mos miratimin e paketës ligjore anti-shpifje të propozuar nga Këshilli i Ministrave, e cila cënon standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes. Gjithashtu, së bashku me 23 organizata të shoqërisë civile kemi reaguar për mosmiratimin e paketës ligjore anti-kçk, pasi cenon pavarësinë e prokurorisë dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Thirrjet e organizatave kundër këtyre dy paketave u shoqëruan me indiferendizëm nga ekzekutivi dhe legjislativi, dhe në disa raste, me deklarata me nota fyese dhe intimiduese ndaj tyre.

xiv. Në tërësi, vijon të mbetet problematik konsultimi publik i nismave ligjore, i cili ka nota formale, kryhet në afate të ngushta dhe në kundërshtim me afatet ligjore si dhe nuk reflekton reagimin e institucioneve ndaj sugjerimeve të dhëna nga grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile.

SITUATA E RESPEKTIMIT TË TË DREJTAVE DHE LIRIVE TË NJERIUT GJATË VITIT 2019

RAPORTI I PLOTË

1. Zbatimi i reformës në drejtësi

KShH ka vijuar me monitorimin profesional dhe objektiv e procesit të vettingut të gjyqtarëve dhe prokurorëve në vendin tonë. Të dhënat statistikore mbi ecurinë e procesit të vettingut deri në dhjetor të vitit 2019, tregojnë se për një periudhë gati 2 vjeçare nga organi i shkallës së parë të vettingut, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (KPK) janë dhënë 223 vendime për subjektet e rivlerësimit (gjyqtarë, prokurorë, ndihmës ligjorë, etj). Procesi i rivlerësimit ka vijuar me ritme relativisht të ngadalta pasi vetëm 27% e subjekteve i janë nënshtruar procesit të vettingut në fazën e parë. Nga këto, rezulton se 83 gjyqtarë/prokurorë janë shkarkuar nga detyra, 97 janë konfirmuar në detyrë, ndërkohë që për pjesën tjetër është pushuar apo ndërprerë procesi i vettingut si rezultat i dorëheqjes apo daljes në pension. Ndërkohë për 102 subjekte është ushtruar e drejta e ankimit në Kolegj nga ana e Komisionerit Publik, ose vetë subjekti i rivlerësimit. Kolegji i Posaçëm i Apelit është shprehur me vendim përkatësisht për 46 ankime. Gjatë 6 muorit të parë të vitit 2019 u konstatua një farë përshpejtimi në procesin e vettingut, duke e krahasuar atë me vitin 2018. E megjithatë pati një ulje të ritmit të punës në veprimtarinë e KPK-së, në muajt Shtator – Tetor të vitit 2019.

Gjatë vitit 2019, qytetarët kanë luajtur një rol të rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij procesi, nëpërmjet depozitimit të ankesave pranë organeve të vettingut si dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (ONM). Bashkëpunimi i qytetarëve në procesin e vettingut vlerësohet si pro-aktiv, tregues i besimit të tyre në rezultatet e tij.

Në këndvështrimin krahasues në të kaluarën, standarti i arsytimit të vendimeve të dhëna nga KPK dhe KPA paraqet një përmirësim. Kjo vjen edhe si rezultat i maturimit të përvojës së institucioneve. Vendimet e KPA-së paraqesin një standart më të mirë dhe më të konsoliduar sa i takon strukturës së vendimit por gjithashtu edhe cilësisë së tij. Si në vendimet e KPK-së dhe në ato të KPA-së pasqyrohet në mënyrë të detajuar mendimi i gjyqtarëve të pakicës ose mendimi paralel.

Maturimi i institucioneve të vettingut, rekomandimet e ONM-së, ankimet e Komisionerëve Publikë kanë kontribuar në konsolidimin e jurisprudencës së organeve të vettingut. Të gjithë këto faktorë, përfshi edhe orientimet e dhëna nga Kolegji i Posaçëm i Apelit vlerësohet të ketë ndikuar pozitivisht në përmirësimin dhe adresimin e disa çështjeve të diskutueshme për standartet e ndryshme të vërejtura në të kaluarën. Kjo vërehet për elementë që kanë të bëjnë me nocionin e burimit të ligjshëm të të ardhurave, pamjaftueshmërisë së të ardhurave, kohështirjes së procesit të vettingut (nëse ky proces do të shtrihet vetëm gjatë ushtrimit të detyrës nga gjyqtari/prokurori apo edhe para tij), pasaktësisë e plotësimit të deklaratës vetting dhe pasaktësive të vërejtura ndër vite në deklaratat periodike që subjektet kanë paraqitur në ILDKPKI, raportit midis këtyre deklaratave, etj). Vlen të theksohet se Kolegji ka përpunuar dy metodologji orientuese me indikatorë dhe nën-indikatorë për vlerësimin e kriterit të aftësive profesionale dhe një metodologji për vlerësimin a kriterit pasuror. Kërkesa për të elaboruar standartet për vlerësimin profesional është adresuar nga vëzhguesi i ONM-së dhe Komisionerët Publik, të cilët kanë identifikuar gjetje dhe mangësi në lidhje me çështjet e marra në vlerësim nga KPK për kriterin e aftësive profesionale.

Pozitiv gjithashtu është fakti se të trija organet e vettingut kanë kryer një hetim të thelluar administrativ për të trija kriteret, duke mos u mjaftuar me të dhënat dhe gjetjet e rezultuara nga organet ndihmëse të vettingut. Mgjth, sërish vërehet që kriteri i pasurisë është kriteri mbizotërues që ka çuar në shkarkimin e një numri të konsiderueshëm subjektësh, në raport me dy kriteret e tjera. Zbatimi i parimit të proporcionalitetit për shkeljet e konstatuara në kriterin e pasurisë, nuk mund të thuhet që ka ndjekur plotësisht një linjë të unifikuar vendimmarrje nga organet e vettingut, në mënyrë të veçantë për subjektet që kanë rrethana faktike apo procedurale të ngjashme.

Pavarësisht nga domosdoshmëria e reformës në drejtësi, mbështetur edhe në informacionet e institucioneve kompetente rezulton se si në gjykatë edhe në prokurori u krijuan vakanca të theksuara, çka krijuan pengesa për aksesin e qytetarëve në organet e drejtësisë. Gjatë vitit 2019, nuk kanë qenë funksionale dy organe të rëndësishme të sistemit të drejtësisë: Gjykata e Lartë dhe Gjykata Kushtetuese. Vakancat kanë krijuar grumbullim të një numri të konsiderueshëm çështjesh penale, civile dhe administrative në Gjykatën e Lartë.

Në fund të vitit 2018, u ngritën rreth 20 muaj me vonesë nga parashikimet ligjore dy institucionet e reja të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (KLP) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Që nga momenti i krijimit, të dy Këshillat u përballën me vështirësi dhe mungesa përsa i përket infrastrukturës, buxhetit dhe pajisjes me personelin e nevojshëm. Gjithashtu, Këshillat u përballën me një ngarkesë dhe volum të lartë pune, sa i takon çështjeve të rëndësishme të qeverisjes së sistemit të prokurorisë dhe atij gjyqësor.

Disa nga aspektet pozitive të vërejtura në veprimtarinë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë janë:

- a) Ngritja e një faqe zyrtare interneti, e cila është lehtësisht e aksesueshme, e mirëorganizuar, e thjeshtë në përdorim.
- b) Miratimi i akteve nënligjore që kanë qenë të nevojshme për ushtrimin e kompetencave prioritare të Këshillit, sikurse ka qenë: a) ngritja e SPAK; b) përzgjedhja e Prokurorit të Përgjithshëm; c) rregullat që kanë lidhje me vlerësimin etik dhe profesional të subjekteve në procesin e rivlerësimit.
- c) Emërimi i përhershëm i 8 prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si dhe emërimi i drejtuesit të kësaj prokurorie.

Për periudhën në vijim, KShH vlerëson si nevojë për tu adresuar në veprimtarinë e KLP-së, plotësimi i kërkesave ligjore për publikimin e përmbledhjeve të procesverbaleve, arsyetimit të vendimeve me karakter individual, publikimit të materialeve lidhur me veprimtarinë e Komisioneve të Përhershme dhe Komisionet e Posaçme të KLP-së, nevoja për përcaktimin e çështjeve prioritare që do të adresohen nga Këshilli për vitin 2020, nevoja për të plotësuar më tej kuadrin normativ të Këshillit, duke miratuar aktet përkatëse, etj.

Disa nga aspektet pozitive të vërejtura në veprimtarinë e KLGJ-së gjatë vitit 2019 janë:

- a) Miratimi i Planit Strategjik për vitin 2019-2020, ku janë vendosur një sërë prioritetesh;
- b) Volum i lartë për miratimin e akteve të shumta nënligjore, si dhe një numër aktesh individuale dhe kolektive për gjyqtarët.
- c) Krijimi i Dosjes Personale dhe Regjistrit të Gjyqtarëve (në format shkresor dhe elektronik), etj.

Sfidë në veprimtarinë e KLGJ-së përgjatë vitit 2019 vlerësohen të jenë çështje të tilla si, ritmet jodinamike për përzgjedhjen e kandidatëve jo gjyqtarë në GJL, mosfillimi i procedurave për plotësimin e vakancave në Gjykatën e Lartë nëpërmjet ngritjeve, nevoja për përmirësimin e transparencës së KLGJ sa i përket mbledhjeve të komisioneve të tij të përhershme dhe të përkohshme, nevoja për përmirësimin e mëtejshëm të faqes zyrtare, ri-organizimi i gjykatave, ndjekja me ritme dinamike i procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve në Gjykatën e Lartë, sidomos ndaj atyre që përfaqësojnë gjyqësorin. Rregullat në lidhje me transferimin, skemën e delegimit dhe transferimet e përkohshme të gjyqtarëve nga KLGJ kanë nevojë të harmonizohen, qartësohen dhe përmirësohen më shumë. Nga studimi i vendimeve dhe diskutimeve në mbledhjet plenare nuk doli e qartë përse Këshilli nuk e ka përdorur asnjëherë, në gjashtë mujorin e parë të 2019-ës, caktimin e përkohshëm sipas nenin 59 të ligjit 96/2016.

Ndonëse anëtarët e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (KED) janë emëruar për dy herë radhazi në vitet e kaluara (2017 dhe 2018) m ky institucion, pa u mbështetur në një bazë ligjore të konsoliduar, nuk funksionoi, çka krijoi pengesa në drejtim të mosfunksionimit të Gjykatës Kushtetuese dhe emërimit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. KED i zgjedhur për vitin 2019 ishte i pari që filloi funksionimin në menyrë të plotë. Janari i vitit 2019 shënoi fillimin e aktivitetit të KED-së.

Në muajt e parë të punës, aktiviteti kryesor i KED ka qënë voluminoz për shkak të përgatitjes së akteve nënligjore. Pas miratimit të tyre, KED ka filluar nga veprimtaria për procedurat lidhur me plotësimin e vakancave të para në Gjykatën Kushtetuese dhe për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Në periudhën 15 Janar – 30 qershor 2019 KED ka marrë 30 vendime në lidhje me 20 kandidatë të tërhequr nga gara (ILD dhe GJK) si dhe 14 vendime mbi 7 kandidatë të ndaluar nga kandidimi (GJK). Disa prej tyre janë tërhequr për shkak të pamundësisë për të dorëzuar dokumentacionin (për ata që kanë paraqitur shkaqe në dorëheqje). Vendimmarrja e KED për lejimin e kandidimit për subjektet që kanë shprehur interes për GJK dhe ILD, për verifikimin dhe pikëzimin e kandidatëve janë kryer në pjesën e dytë të vitit 2019 si dhe në fillim të vitit 2020. Vërehet një numër i ulët kandidaturash që plotësojnë kriteret dhe kushtet formalo – ligjore si për në GJK dhe për ILD, tregues i faktit se këto kritere janë të forta dhe se burimet njerëzore të interesuara për këto pozicione janë të pamjaftueshme për të garantuar një konkurrueshmëri të lartë midis kandidaturave. Psh, për vakanca të ndryshme për anëtar të GJK, u vërejtën në disa raste të njëjtët emra.

Në fund të vitit 2019, u plotësuan 3 vakanca në Gjykatën Kushtetuese, ndërkohë që u krijua gjithashtu një situatë jo të zakonshme për reformën e re në sistemin e drejtësisë lidhur me vendin e dytë vakant në këtë Gjykatë, ku rezultojnë dy anëtarë «të emëruar» (një në heshtje dhe një me dekret të Presidentit). Krijimi i ngërçit erdhi si rrjedhojë e mosrespektimit të radhës kronologjike për plotësimin e vakancave në këtë gjykatë, të shpallura nga Presidenti dhe Kuvendi, e cila u shoqërua me:

- i) mungesën e një dialogu konstruktiv dhe profesional në trinomin e institucioneve Kushtetuese, President, Kuvend dhe KED;
- ii) përcjelljen e një kallëzimi penal pranë organit të Prokurorisë së Posaçme SPAK në muajin Nëntor 2019 nga Presidenti ndaj Kryetarit të KED duke e akuzuar atë për veprën penale të “Shpërdorimit të Detyrës”;
- iii) konsultimin e Komisionit të Venecias, institucion të cilit i është kërkuar një opinion mbi procesin e emërimit në Gjykatën Kushtetuese i paraqitur nga Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë në muajin Dhjetor 2019, i pasuar nga një kërkesë e ngjashme e paraqitur nga Presidenti i Republikës në muajin Janar 2020.

Vonesat në ngritjen e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (i cili u zgjodh nga Kuvendi në Janar të vitit 2020), për shkak të mospërmblidhjes së kriterëve formalo – ligjore nga një numër i caktuar kandidatësh, paralizuan funksionimin normal të mekanizmit disiplinor ndaj gjyqtarëve dhe prokurorëve, gjatë vitit 2019.

2. Lufta kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Prej më shumë se tre vitesh në vendin tonë ka hyrë në fuqi Ligji nr. 60/2016 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”, i cili ndër të tjerash ka si qëllim parandalimin dhe goditjen e korrupsionit në sektorin publik e privat, nxitjen e sinjalizimeve dhe mbrojtjen e sinjalizuesve të korrupsionit.

Gjatë monitorimit të veprimtarisë së Inspektoriatit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) dhe 11 Ministrive të linjës, KShH konstatoi se **nuk rezultoi të jetë bërë asnjë sinjalizim i brendshëm në Ministrinë e linjës. Ndërkohë që deri në fund të 2019-ës, rezultoi vetëm një sinjalizim i jashtëm ndaj Ministrisë së Drejtësisë, i paraqitur pranë ILDKPKI-së si institucioni përgjegjës për shqyrtimin e këtyre sinjalizimeve.**

Arsyet kryesore të cilat kanë çuar në mungesën e sinjalizimeve nga një numër jo i vogël nëpunësish në Ministrinë e linjës rezultojnë të jenë: mungesa e informimit mbi legjislacionin për sinjalizimin, mungesa e besimit se sinjalizimi i realizuar do të trajtohet në mënyrë të paanshme dhe profesionale, frika nga hakmarrja, ekzistenca e platformave të tjera paralele të raportimit/ankimit, mungesa e fakteve apo provave për të vërtetuar veprat korruptive, etj.

Ngritja me vonesë e SPAK-ut në fund të vitit 2019, për shkak të mungesës së kandidaturave dhe efekteve të procesit të vettingut ndikoi në ngadalësimin e luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Reforma në arsimin e lartë nuk adresoi dhe rrjedhimisht as nuk kontribuoi për të luftuar korrupsionin në radhët e drejtuesve, personelit akademik dhe logjistik të sistemit të lartë universitar. Sondazhi i kryer nga KShH me një kampion të gjerë prej 1799 studentë të 4 universiteteve në vend¹, por gjithashtu edhe rastet e publikuara në media, evidentojnë prezencën e korrupsionit në radhët e personelit akademik dhe logjistik. Shqetësues paraqitet raportimi nga studentët e anketuar për favoret seksuale nga pedagogët e tyre, ku rreth rreth 25% e studentëve (ose 1 në 4 studentë) të anketuar referuan se kanë qenë subjekt i kërkesave apo presioneve për favore seksuale nga pedagogët në këmbim të notes.

3. E drejta për të zgjedhur e për t’u zgjedhur

Me asistencën e 115 vëzhguesve, KShH ka monitoruar procesin zgjedhor për organet e qeverisjes vendore të dt.30 Qershor 2019. Raportimi i vëzhguesve ka qenë i saktë dhe objektiv, edhe pse këto zgjedhje u zhvilluan në një situatë elektrizuese dhe jo normale. Situata tejet e politizuar u shoqërua me forma të ndryshme presioni ndaj zgjedhësve, për të ushtruar ose jo të drejtën e tyre kushtetuese të votës. Në raport me pjesëmarrjen e zgjedhësve në zgjedhjet e mëparshme parlamentare të vitit 2017 konstatohet një rënie prej 23.76% të numrit të zgjedhësve, ndërkohë në raport me zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të vitit 2015 vërehet se 24.9% me pak zgjedhës i janë drejtuar qendrave të votimit.

¹ “Aleksandër Moisiu” Durrës, “Aleksandër Xhuvani” Elbasan, “Ismail Qemali” Vlorë dhe “Luigj Gurakuqi” Shkodër

Vlen të theksohet se procesi parazgjedhor është shoqëruar nga incidente të shumta dhe akte të dhunshme të ndërmarra ndaj Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor (KZAZ-ve). Ditën e votimit në disa Bashki të vendit, vëzhguesit e KShH-së vërejtën prezencë të personave të paautorizuar, në ambientet e brendshme të qendrave të votimit (QV) dhe në ambientet e jashtme, por brenda perimetrit të godinës ku ishin vendosur këto qendra. Ndërkohë procesi i numërimit të votave u realizua në një mjedis përgjithësisht të qetë dhe transparent, por u karakterizua nga vonesa në ngritjen e grupeve të numërimit të votave (GNV).

Gjatë monitorimit u konstatua se partitë opozitare nuk u regjistruan si subjekte zgjedhore. Numri total i kandidatëve për Kryetar Bashkie në këto zgjedhje ishte 97, ndër të cilët vetëm 11 femra. Kjo shifër tregon një pjesëmarrje dhe përfaqësim të ulët, afro 10% të gruas për të kandiduar në nivel kryetar bashkie. Ndërkohë në 31 Bashki konkurroi në garën për Kryetar vetëm 1 kandidat. Mungesa e kandidatëve alternativë si dhe fakti që në legjislacionin tonë nuk parashikohet një minimum votash për tu zgjedhur fitues (fitues shpallet ai kandidat që ka fituar më shumë vota), bëri që për zgjedhjet në këto Bashki të mos kishte garë.

KShH i ka kushtuar vëmendje të veçantë veprimtarisë së Komisionit të Posaçëm Parlamentar të Reformës Zgjedhore. Situata e polarizuar ka ndikuar gjithashtu në ngadalësimin e e theksuar të punës së tij. Veprimtaria konsultuese e këtij komisioni ka patur nota kryesisht formale dhe grupet e interesit janë thirrur në një kohë tepër të shkurtër për të dhënë kontributet e tyre në proces. KShH vlerëson se rekomandimi kyç i OSBE/ODIHR për depolitizimin e të gjitha niveleve të organeve të administrimit zgjedhor nuk ka gjetur reflektim në amendamentet e propozuar nga ekspertët e atashuar pranë këtij Komisioni.

Lidhur me reformën zgjedhore, KShH ka kontribuar me propozimet dhe sugjerimet e tij duke patur parasysh Rekomandimet e OSBE/ODIHR-it. Në raportet e 3 zgjedhjeve të fundit, KShH ka bërë gjithashtu propozime konkrete edhe për tre draftet që i janë dërguar atij nga Komisioni i Reformës Zgjedhore. Është pozitiv fakti që kohët e fundit marrin pjesë në punimet e këtij komisioni janë edhe përfaqësues të opozitës jashtë parlamentare, por marrëveshja politike e arritur mes palëve, afati i dakordësuar (15 Mars) dhe mënyra se si po realizohet diskutimi, ka përjashtuar gjithëpërfshirjen dhe konsultimin me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit të kësaj reforme zgjedhore.

4. Aksesit në drejtësi i grupeve vulnerabël

I miratuar në kuadër të reformës në drejtësi, ligji nr.111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, synon ndër të tjerash të krijojë një sistem për ofrimin e ndihmës juridike falas, për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. **Edhe pse ky ligj ka hyrë në fuqi në dt.1 Qershor të vitit 2018 (një vit e gjysëm më parë), KShH vëren se procesi i zbatimit është shoqëruar me vonesa të konsiderueshme në aspektin e hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore.**

Gjatë periudhës Dhjetor 2018 – Tetor 2019, KShH monitoroi funksionimin e skemës së ofrimit të ndihmës juridike falas parësore. Ligji nr. 111/2017 ka parashikuar si pjesë të mekanizmit të ofrimit të ndihmës juridike parësore: a) Qendrat e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore, b) Klinikat e Ligjit pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë dhe c) Organizatat jofitimprurëse (OJF) të autorizuar nga ana e Ministrit të Drejtësisë. Monitorimi evidentoi se, **vetëm Qendra e Shërbimeve të Ndihmës Parësore Falas pranë Bashkisë Elbasan ka filluar nga funksionimi. Sa i përket OJF-ve, ato akoma nuk janë autorizuar nga Ministria e Drejtësisë, edhe pse tashmë, janë miratuar aktet nënligjore lidhur me rregullat dhe procedurat e autorizimit. Për rrjedhojë, akoma nuk ka filluar dhe skema e financimit nga buxheti i shtetit për OJF-të.**

Klinikat e ligjit të cilat janë funksionale qysh përpara hyrjes në fuqi të ligjit, janë të vendosura pranë universiteteve dhe nuk janë mbështetur financiarisht nga shteti.²

5. Të drejtat e grupeve të marginalizuara në këndvështrimin e KShH-së

Grupet në nevojë vijojnë të përballen me forma të ndryshme të diskriminimit. Ndër grupet më të prekura janë përfaqësues të Minoritetit Rom dhe Egjiptian, personat me orientim të ndryshëm seksual apo për shkak të identitetit të tyre gjinor, gratë, si dhe personat që jetojnë në kushte tepër të vështira jetese dhe të varfërisë. KShH vëren se nevojitet një angazhim më i lartë dhe efektiv i shtetit për përmbushjen e objektivave sociale të parashikuara në nenin 59 të Kushtetutës, për punësimin në kushte të përshtatshme të personave të aftë për punë, për të garantuar standartin më të lartë shëndetësor, fizik dhe mendor të ndryshëm, për garantimin e një mjedisi të shëndetshëm, për përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët, etj.

Pavarësisht ndryshimeve në legjislacion, shumë familje rome dhe egjiptiane, por edhe familje të tjera në nevojë, nuk kanë strehim adekuat dhe vijojnë të mos përfitojnë efektivisht nga programet e strehimit social. KShH ka marrë dhe trajtuar ankesa për shkelje të të drejtave, nga persona që i përkasin Komunitetit LGBTIQ, si dhe i ka adresuar ato pranë institucioneve përgjegjëse.

Fenomeni i dhunës në familje vijon të marrë jetën e shumë vajzave dhe grave të pafajshme, si dhe të dëmtojë integritetin e tyre fizik dhe mendor. **Mekanizmat e referimit të dhunës në familje nuk kanë funksionuar gjithmonë si duhet, ndërkohë që denoncimeve të vajzave dhe grave në organet e policisë së shtetit jo gjithmonë i është dhënë rëndësia e duhur.**

Nga trajtimi i ankesave mbi çështjet e pronësisë, **KShH ka vërejtur mosrespektim të afateve dhe procedurave ligjore nga ana e Inspektoratit Kombëtar për Mbrojtjen e Territorit (IKMT).**

Rikthimi i familjeve dhe shtetasve shqiptarë në vendin e tyre të origjinës, për shkak se nuk kanë përmbushur kushtet e qëndrimit në vendet e Bashkimit Evropian apo kanë kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin, ka sjellë pasoja dhe vështirësi në drejtim të integritetit të tyre në punë, në shkollë, në përfitimin nga programet e mbështetjes sociale, etj. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, KShH, me ndihmën e një rrjeti psikiatrick dhe psikologësh po ofron mbështetje mbështetje psikiatrike, psikosociale dhe psikologjike për 44 shtetas, ndër të cilët 35 janë të rikthyer nga Gjermania ose vendet e tjera të BE-së. Kjo asistencë po ofrohet edhe për qytetarët e dëmtuar nga tërmeti, me qëllim riintegrimin e tyre në jetën sociale dhe aksesin e tyre në shërbimet e institucioneve shtetërore.

6. Ofrimi i shërbimeve ligjore falas ndaj qytetarëve, përfaqësimi në gjykatat vendase dhe në Gjykatën e Strasburgut

Gjatë vitit 2019, KShH ka trajtuar 187 ankesa të përcjella nga qytetarët. Rreth 90% e këtyre ankesave i përkasin kategorisë së individëve të ndodhur në kushtet e kufizimit të lirisë. Individët në kushtet e kufizimit të lirisë janë ankuar kryesisht për keqtrajtim nga stafi me uniformë në Policinë e Shtetit dhe në sistemin e Burgjeve, për mungesën e trajtimit të përshtatshëm mjekësor, për cenimin e procesit të rregullt ligjor në organet e drejtësisë, për cenimin e të drejtës për jetë

² Për më tepër shih: https://ahc.org.al/wp-content/uploads/2019/12/Raport-Ndihma-Juridike-per-publikim-_Komiteti-Shqiptar-i-Helsinkit.pdf

private dhe familjare lidhur me mosmarrjen parasysh të kërkesave të tyre për transferim në institucione pranë vendbanimit të familjarëve të tyre. **Rreth 10% e ankesave janë adresuar nga shtetas të tjerë lidhur me dhunën në familje, diskriminimin gjatë marrëdhënieve të punës si dhe ankesa ndaj sistemit të drejtësisë.**

Në rastet kur kemi konstatuar shkelje të të drejtave dhe lirive të këtyre shtetasve, KShH i është drejtuar organeve përgjegjëse shtetërore me rekomandime për të rivendosur në vend të drejtën e cënuar. Kryesisht, organet shtetërore janë treguar proaktive në dhënien e përgjigjeve ndaj shkresave zyrtare të adresuara nga KShH. Vlen të evidentohet si pozitiv, bashkëpunimi me Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve, e cila ka reaguar për çdo ankesë të përcjellë pranë saj, pavarësisht se në disa raste, reflektimi lidhur me rekomandimet e adresuara nuk ka sjellë ndryshimin e situatës së adresuar.

Gjatë vitit 2019, KShH ka vijuar të ndjekë disa raste të veçanta të shkeljes së të drejtave të njeriut, pranë sistemit gjyqësor vendas dhe Gjykatës së Strasburgut. Ndjekja e këtyre rasteve është realizuar duke ofruar shërbim avokator falas për individët ose drejtpërdrejt nga KShH, si organizatë legjitime që përfaqëson interesin publik të qytetarëve. **Në praktikën gjyqësore, janë shënuar disa zgjidhje të suksesshme të këtyre çështjeve, ku vlen të përmendim detyrimin e organeve përgjegjëse administrative nga gjykata për të sanksionuar ndotësit e lumit Gjanicë dhe për të rehabilituar zonat e prekura nga ndotja; detyrimin e organeve shëndetësore për t'i vendosur implantin koklear, të miturit me nevoja specifike dëgjimore; etj.**

E drejta e jetës dhe ajo e mbrojtjes së shëndetit përbëjnë ndër të drejtat themelore të cilat cënohen gjatë kryerjes së veprimeve ose mosveprimeve inaktive nga ana e përfaqësuesve të sistemit penitenciar. **Në muajin Shtator 2019, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në çështjen Prizreni kundër Shqipërisë (Aplikim nr. 29309/16), të përfaqësuar nga avokatët e KShH-së, konstatoi se vdekja e të dënuarit në kushtet e privimit të lirisë nën mbikqyrjen e autoriteteve dhe akuzat e vëllait të tij për keqtrajtim nuk janë hetuar në mënyrë efektive nga organi i akuzës. Gjykata konstatoi se autoritetet shqiptare kishin dështuar të respektonin garancitë procedurale të nenit 2 të Konventës, që garanton të drejtën e jetës.**

KShH i ka kushtuar një vëmendje të shtuar garantimit të respektimit të dinjitetit njerëzor të subjekteve të posaçëm, përfaqësuesve të Policisë së Shtetit dhe atyre të Byrosë Kombëtare të Hetimit. Në ligjet e posaçme nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar” dhe nr. 12/2018, “Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme” është parashikuar se shmangia ose refuzimi i kandidatit për t’iu nënshtruar testit të poligrafit i heq atij të drejtën e kandidimit. Në vitin 2018, KShH i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të dispozitave që parashikojnë përdorimin e testit të poligrafit. Në muajin Janar 2020, KShH është njoftuar se Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak, Mbledhjes së Gjyqtarëve. Aktualisht mbetemi në pritje të formimit të kuorumit të nevojshëm pranë Gjykatës Kushtetuese, lidhur me shqyrtimin e kërkesës që KShH ka depozituar pranë saj.

Gjatë vitit 2019, është konstatuar sensibilizim në rritje i qytetarëve përsa i përket garantimit të respektimit të së drejtës për një mjedis të pastër. Avokatët e KShH-së kanë përfaqësuar në mënyrë të suksesshme pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë, interesin publik dhe pretendimet e 3 banorëve, me qëllim detyrimin e autoriteteve publike kompetente si Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) dhe Inspektoriati Shtetëror i Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit

(ISHMPUT), për ushtrimin e kompetencave që ligji u ka ngarkuar, ndaj operatorëve ndotës të lumit Gjanica. Si rrjedhojë e mos ushtrimit të së drejtës së ankimit, vendimi mori formë të prerë, dhe aktualisht ndodhet në proces ekzekutimi.

Në 29 raste, KShH ka reaguar publikisht me anë të deklaratave, letrave apo opinionëve të hapura, për çështje të rëndësishme dhe kryesisht për ato që kanë cenuar të drejtat dhe liritë e shtetasve, përfshi këtu edhe cenimin e parimit të rëndësishëm kushtetues të prezumimit të pafajësisë. Këto reagime janë bërë objekt informacioni edhe nëpërmjet medias, duke kontribuar në drejtim të ndërjegjësimit të qytetarëve dhe autoriteteve publike.

7. Respektimi i të drejtave të personave të ndodhur në kushtet e kufizimit të lirisë

KShH ka realizuar 33 misione monitorimi në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale (IEVP) dhe në terren, me qëllim verifikimin e ankesave të përcjella nga individët si dhe të rasteve të bëra publike në media. Aksesit i vëzhguesve të KShH-së në IEVP-të ka qenë i pakufizuar, në respekt të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe Komitetit Shqiptar të Helsinkit. Vetëm në një rast, vëzhguesve të KShH-së ju është kufizuar aksesit **në njohjen dhe verifikimin e kartelave mjekësore, gjatë monitorimit tematik të realizuar në IEVP Ali Demi (325), më dt. 30 Korrik 2019. Ky kufizim bie ndesh me dispozitat e marrëveshjes së sipër përmendur.**

Gjatë vitit 2019, KShH ka trajtuar 10 ankesa nga të paraburgosurit/dënuarit, të cilët kanë pretenduar se janë dhunuar fizikisht nga stafi me uniformë i policisë së shtetit ose i policisë së burgjeve. Në disa raste, në trupin e të dënuarve janë konstatuar shenja dhunë nga ekspertët vëzhgues (mjekoligjor) të KShH-së. **KShH shpreh shqetësimin mbi rritjen e numrit të ankesave të referuara për ushtrim dhune brenda institucioneve të mbyllura, në krahasim me 3 ankesa të trajtuara gjatë vitit 2018.**

Gjetjet dhe konkluzionet e rasteve të verifikuara, sa i takon pretendimeve për ushtrim dhune, i janë përcjellë në rrugë zyrtare nga KShH, institucioneve shtetërore përgjegjëse. Gjatë monitorimeve të këtyre rasteve është vërejtur se nuk ka gjetur zbatim rekomandimi i Komitetit për Parandalimin e Torturës (KPT), për detyrimin e stafit mjekësor të institucioneve të privimit të lirisë që ekzaminon këta shtetas, për të denoncuar këto ankesa në prokurori brenda një afati sa më të arsyeshëm. Në disa raste ku shenjat e dhunës ishin të dukshme, KShH ka vendosur në lëvizje edhe organin e prokurorisë dhe ka kërkuar informacion lidhur me ecurinë e procedimit penal. Nga korrespondenca që kemi patur me prokurorinë, vërejmë se hetimi ndaj rasteve të referuara për ushtrim dhune nuk ka qenë i plotë dhe i gjithëanshëm.

Në disa prej IEVP-ve të monitoruara, të dënuarit dhe të paraburgosurit vazhdojnë të qëndrojnë në kushte të vështira, veçanërisht në drejtim të infrastrukturës. KShH ka vërejtur mungesa në personelin mjekësor dhe atë psiko-social në institucionet penitenciare, ndërkohë që tepër shqetësuese është rritja e numrit të personave të privuar nga liria me sëmundje apo probleme të shëndetit mendor. Mbipopullimi në disa institucione vijon të mbetet shqetësues, ku vlen të përmendim mbipopullimin e konstatuar gjatë monitorimit të realizuar në Institucionin e Veçantë (IEVP) Zahari, Krujë. Kapacitetet maksimale të akomodimit në këtë institucion janë për 196 persona³, ndërkohë në vizitën monitoruese të realizuar në muajin Shtator 2019, vëzhguesit e KShH-së konstatuan akomodimin e 284 shtetasve, pra rreth 88 shtetas mbi kapacitet.

³ <http://www.dpsh.gov.al/newweb/?fq=brenda&gj=gj1&kid=19>

KShH vlerëson se Urdhëri i Transferimit nr. 9460/5, dt. 02.10.2018 i Drejtorisë së Përgjithshme e Burgjeve dhe Urdhëri nr. 2529, dt. 03.04.2016 i Ministrisë së Drejtësisë, mbi transferimin e 73 shtetasve me masë mjekësore “Shttrim i përkohshëm” apo “Mjekim i detyruar” nga Spitali i Burgjeve (IVSHB, Tiranë) në IEVP Krujë, përpos domosdoshmërisë për kategorizimin e IEVP-ve duhet të referohej në një analizë të kushteve infrastrukturore, burimeve njerëzore dhe kapaciteteve funksionale të IEVP Krujë. KShH rekomandon rishikimin e këtyre urdhërave dhe shmangien e arsyetimeve *extra ligjore* në përmbajtjen e tyre. Personat me masë mjekësore “mjekim i detyruar” vijnë të mbahen në kundërshtim me ligjin në sistemin e burgjeve dhe për këtë kategori nuk është ngritur një institucion i posaçëm mjekësor. KShH dëshiron të sjellë në vëmendje kërkesat e vazhdueshme, prej disa vitesh, të KShH-së, Avokatit të Popullit dhe Komitetit për Parandalimin e Torturës për mbylljen e IEVP Krujë dhe për akomodimin e personave me masë mjekësore në një institucion të posaçëm dhe të specializuar mjekësor.

Në çështjen e shtetasit shqiptar me masë mjekësore, Strazimiri kundër Shqipërisë (Aplikim nr. 34602/16), Gjykata e Strasburgut (GJEDNJ) vendosi unanimitet se autoritetet shqiptare kanë dështuar prej një kohe tepër të gjatë të sigurojnë një institucion të posaçëm mjekësor për të dënuarit me sëmundje të shëndetit mendor, të cilëve ju është kufizuar liria mbi bazën e një vendimi gjyqësor për mjekimin e detyruar. Në këtë çështje të përfaqësuar nga avokatët e KShH-së, GJEDNJ konstatoi se situata bie në kundërshtim me detyrimet ligjore të parashikuara në legjislacionin e brendshëm dhe përbën për vendin tonë një problem strukturor.

Përgatitja më e mirë profesionale e personelit të burgjeve, forcimi i kushteve dhe kriterëve për marrjen në punë, si në drejtim të integritetit profesional dhe atij moral, rritja e pagës dhe shpërblimit në raport me kushtet tepër të vështira në të cilat punojnë, është i një rëndësie të veçantë. **Lëvizjet e shpeshtë në administratën e burgjeve, sikurse ka ndodhur gjatë vitit 2019, sidomos në nivelin e lartë drejtues, nuk kanë sjellë përmirësim të performancës dhe nuk do të ishin të rekomandueshme në parim.**

8. Qasja e të rinjve ndaj tolerancës fetare

Gjatë vitit 2019, KShH ka kontribuar në promovimin dhe mbrojtjen e lirisë së besimit dhe fesë në Shqipëri, duke realizuar një sërë aktiviteteve ndërgjegjësuese si psh, forume me nxënës dhe orë të hapura me të rinjtë në 8 qytete të vendit, për të diskutuar në lidhje me çështje të ndryshme të tolerancës fetare dhe bashkëjetesën ndërmjet shqiptarëve.

Qasja pozitive dhe pranimi i debateve dhe diskutimeve të rregullta mbi lirinë e besimit fetar nga studentët dhe nxënësit ka lehtësuar angazhimin e mëtejshëm jo vetëm të shkollave por edhe të organizatave të shoqërisë civile, lidhur me trajtimin e çështjeve të besimit fetar.

KShH realizoi një studim mbi promovimin e mirëkuptimit, tolerancës dhe lirisë fetare në Shqipëri, të dhënat e të cilit u bazuan ndër të tjerash në rezultatet e intervistimit të një kampioni prej 1.114 të rinjve dhe të rejave. Në përputhje me prirjen që shfaqet në nivel evropian, KShH ka konstatuar rritjen e tendencës së të rinjve për të deklaruar që nuk i përkasin asnjë besimi fetar. Pavarësisht se familja vijon të luajë një rol të rëndësishëm në orientimin fetar, 88% e të anketuarve kanë treguar një nivel të lartë tolerance dhe respektimi të diversitetit të besimeve fetare. Në vendin tonë, 56% e të rinjve të anketuar nuk pajtohen me ekzistencën e rregulloreve speciale që ndalojnë përdorimin e veshjeve të orientuara fetare në institucionet arsimore ose publike në përgjithësi. Në terma të

mosdiskriminimit për shkak të besimeve fetare, shumica dërrmuese të rinjve shqiptarë (rreth 86%) deklaruan se trajtohen në mënyrë të barabartë, pavarësisht bindjeve fetare. **KShH vlerëson se ky është një tregues pozitiv i harmonisë fetare, për të cilën shoqëria shqiptare është e njohur përtej kufijve territorialë, rol ky që shpesh përdoret si shembull në rrafshin ndërkombëtar.**

Forumet promovuese të tolerancës fetare të realizuara nga KShH evidentuan se liria e ndërgjegjes dhe e besimit fetar vijon të përbëjë një nga vlerat dhe tiparet dalluese më të mira të shoqërisë shqiptare. **KShH rekomandon inkurajimin dhe intensifikimin e organizimit të aktiviteteve shkollore që sigurojnë rritjen e vetëdijes rreth dialogut ndërkulturor dhe ndërfetar, jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe në nivele lokale.**

9. Liria e tubimeve paqësore

Viti 2019 u shoqërua me një sërë protestash/tubimesh nga ana e qytetarëve, disa prej të cilave u shoqëruan me elementë dhe veprime të dhunshme, në disa raste edhe për shkak të ndikimit apo keqpërdorimit të protestave nga partitë politike. KShH ka bërë thirrje të herë pas herë qytetarëve për tubime paqësore, konform kushtetutës dhe për të mos dëmtuar kauzën për të cilët ata reagojnë. Nga ana tjetër, KShH rithekson nevojën për rishikimin e ligjit për tubimet (i miratuar 18 vite më parë) pasi ka patur raste të shoqërimeve apo fillimit të procedimit penal për mbrojtës të të drejtave të njeriut që kanë organizuar dhe kanë marrë pjesë në tubime spontane për të cilat nuk është njoftuar paraprakisht policia. Tubimi spontan nuk parashikohet shprehimisht si formë tubimi në legjislacionin tonë.

Duke marrë parasysh problematikat e qytetarëve të zonës së ASTIR-it, dhe standartet e ndryshme që ishin ndjekur në drejtim të legalizimit të banesave të tyre, KShH ka reaguar për nevojën e respektimit të detyrimeve që rrjedhin nga legjislacioni ndërkombëtar, për t'u konsultuar efektivisht me këta banorë dhe për të gjetur zgjidhje sa më të drejta dhe të përshtatshme që garantojnë dëmshpërblimin dhe strehimin e tyre adekuat.

10. Liria e shprehjes

KShH i është bashkuar organizatave më në zë të medias në Shqipëri, duke bërë thirrje që të mos miratohet paketa ligjore anti-shpifje e propozuar nga Këshilli i Ministrave, pasi kjo paketë nuk respektonte standardet ndërkombëtare dhe parimet e lirisë së medias dhe lirisë së shprehjes. Gjithashtu, KShH inicioi nismën për nënshkrimin e deklaratës për shtyp, nëpërmjet të cilës i bëhej thirrje qeverisë shqiptare për të tërhequr projektligjet e propozuara, nga 37 organizata pjesë e rrjetit ndërkombëtar, Civic Solidarity Platform. **KShH shpreh vlerësim mbi mbështetjen e ofruar nga 9 Komitete të Helsinkit pjesë e këtij rrjeti, kundër miratimit të kësaj pakete ligjore.**

Gjatë vitit 2019, janë shënuar raste të përdorimit të gjuhës diskriminuese, intimiduese, ofenduese dhe jo-etike nga përfaqësuesit e Kuvendit, edhe pse ky i fundit ka miratuar Kodin e Sjelljes së Deputetëve. **KShH ka reaguar publikisht për gjuhën intimiduese dhe fyese të përdorur nga një prej deputetëve të Kuvendit ndaj Avokates së Popullit, për shkak të reagimit të kësaj të fundit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve me sindromën “Down”.**

KShH ka vijuar angazhimin duke bashkëpunuar me gazetarët dhe shoqatat e tyre, veç të tjerave, edhe për respektimin e të drejtave të tyre në marrëdhëniet e punës. Në kuadër të fushatës ndërgjegjësuere që KShH ka ndërmarrë lidhur me këtë çështje, rreth 50 gazetarë kanë përfituar

këshillim ligjor falas, ndërkohë që 3 gazetarë po përfaqësohen në gjykatë, për shkeljet e të drejtave të tyre në marrëdhëniet e punës.

11. Konsultimi publik dhe gjithëpërfshirja në vendimmarrje

KShH i është përgjigjur pozitivisht 23 ftesave për konsultim publik të adresuara nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, Komisionet parlamentare përkatëse, Ministrinë e linjës etj. Konkretisht janë ofruar opoenca ligjore për rezolutën e mbrojtësve të të drejtave të njeriut, për amendimet e parashikuara në legjislacionin e sistemit penitenciar, strategjinë ndërsektoriale periodike të Drejtësisë dhe planit të veprimit, ndryshimet e propozuara në Kodin Penal, llojet dhe masat përkatëse të tarifave gjyqësore të propozuara nga KLGJ etj.

Gjatë muajit dhjetor 2019 dhe në dy muajt e parë të vitit 2020, një grup organizatash të shoqërisë civile reagon në mënyrë të vazhdueshme duke i kërkuar Kuvendit të konsultojë aktin normativ me fuqinë e ligjit, nr.1, dt.31.01.2020 “Për masat parandaluese në kuadër të forcimit të luftës kundër terrorizmit, krimit të organizuar, krimeve të rënda dhe konsolidimit të rendit e sigurisë publike”. Ky akt i miratuar nga Këshilli i Ministrave u realizua në mungesë të transparencës dhe primeve të konsultimit publik dhe gjithëpërfshirjes. Gjithashtu, shqyrtimi i këtij akti normativ nga dy Komisionet Parlamentare (Komisioni i Ligjeve dhe Komisioni për Çështjet e Sigurisë) u realizua pa konsultim publik. KShH së bashku me 23 organizata të shoqërisë civile vërejtën se akti cenon prime të rëndësishme kushtetuese si parimin e ndarjes dhe balancimit të pushteteve, parimin e pavarësisë së prokurorisë, si dhe të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Në tërësi, vijon të mbetet problematik konsultimi me nota formale dhe me afate tepër të ngushta kohore, në kundërshtim me afatet ligjore si dhe mosreagimi i organeve që ndërmarrin konsultimin, për ndryshimet që kanë sjellë komentet dhe sugjerimet e grupeve të interesit në procesin ligjvënës.

ANEKS 1 **TË DHËNA TË KATEGORIZUARA PËR ANKESAT E TRAJTUARA GJATË VITIT 2019**



